LIGJ
Nr.8397, datë 3.9.1998

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE TË PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SI "HUAMARRËSE" PËRFAQESUAR NGA BANKA E SHQIPËRISË, NDËRMARRJA E UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE TË KORÇËS SI AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT" DHE KFW-SË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË , PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË UJËSJELLËSIT DHE TË KANALIZIMEVE TË KORÇËS""

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e huasë, të financimit dhe të projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë si "Huamarrëse", përfaqësuar nga Banka e Shqipërisë, Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve të Korçës si "Agjenci e zbatimit të Projektit" dhe KFW-së së Republikës Federale të Gjermanisë, për financimin e projektit të ujësjellësit dhe të kanalizimeve të Korçës", për shumën 24 milionë DM.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2208, datë 7.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani